Sika është një kompani kimikatesh të posaçme me pozicion kryesues në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve dhe produkteve për ngjitje, izolim, hidroizolim, përforim dhe mbrojtje në sektorin e ndërtimit dhe industrinë e mjeteve motorike.

Sika ka filiale në 100 shtete të botës dhe njësi prodhimi në mbi 300 fabrika. Më shumë se 25,000 punonjësit tanë kontribuan në arritjen e 8.1 miliardë CHF shitje në 2019.

## SIKA NË NJË SHIKIM

| | |
|---|---|
| 25,000+ | PUNONJËS |
| 100 | SHTETE |
| 300+ | FABRIKA NË BOTË |
| 7 | FABRIKA TË REJA NË 2019 |
| 93 | PATENTA TË REJA NË 2019 |
| 5 | BLERJE NË 2019 |
| 8.1 BN | SHITJE NETO NË 2019 |

**STRATEGJIA JONË**
Modeli i rritjes Sika është sinonim i suksesit afatgjatë, si dhe gjithashtu i rritjes së qëndrueshme dhe fitimprurëse. Duke synuar shtyllat kryesore të depërtimit në treg, inovacionin, efikasitetin operacional, blerjet e kompanive, qëndrueshmërinë - dhe drejtimin nga vlerat e forta të korporatës - Sika po rritet me sukses.



**PAUL SCHULER**
CEO

"Me Strategy 2023, Sika do të vazhdojë trajektoren e saj të rritjes dinamike. Falë rrjetit gjithëpërfshirës në të gjithë botën, Sika është e pozicionuar në mënyrë ideale për të përfituar nga ciklet e jetës të sektorit të ndërtimit si në tregjet e reja, por edhe ato të maturuara. Me inovacione që ofrojnë performancë superiore produkti si dhe përfitime qëndrueshmërie, ne synojmë të ofrojmë vlerë shtesë tek klientët tanë dhe të gjitha palët e interesit."

PUNA JONË

# BUILDING TRUST



© Jeff Smith Photography

**NE JEMI ATY**
Produktet tona mund të mos jenë gjithnjë të dukshme, por rezultatet që ato arrijnë duken qartë. Që nga rrethet e reja urbane siç janë "Hudson Yards" në New York, përgjatë të gjithë globit dhe deri në Tunelin Waterview Connection në Zelandën e Re, Sika po lë shenjën e saj në botë.





**MË SHUMË SE 100 VJET EKSPERTIZË**
Reputacioni i Sika-s për cilësi dhe besueshmëri është i pankonkurrueshëm dhe paraqitet nëpërmjet një portofoli gjithëpërfshirës me produkte që zgjidhin probleme që janë përdorur për shumë vite në fusha të ndryshme aplikimesh. Nëse ne jemi duke izoluar bazamentin apo tarracën tuaj, duke izoluar ndërtesën apo makinën tuaj, ose duke punuar me ju në shtëpinë apo ndërtesën tuaj shumëkatëshe, do të shihni përse jemi të njohur për Building Trust.



ÇFARË NA BËN TË SUKSESSHËM

# KURAJË PËR INOVACION

**1000+**
PUNONJËS TË PËRKUSHTUAR PËR KËRKIMIN & ZHVILLIMIN



Historia e gjatë e inovacionit të Sika-s ka çuar në sukses të pashembullt në të qenurit një lider i njohur në teknologjinë botërore në shumë tregje, si dhe në të krijuarit vlerë për klientët e Sika-s. Përveç investimit në të themeluarit qendra të reja teknologjike në të gjithë botën, kompania gjithashtu edukon dhe zhvillon një rrjet ndërkombëtar shkencëtarësh, partnerësh, furnitorësh dhe klientësh.

Ne ofrojmë zgjidhje inteligjente duke përdorur teknologjitë më të përparuara, shërbimin dhe ekspertizën unike. Në fakt ne jemi të mirënjohur për zgjidhjet tona të cilësisë së lartë për ndërtimin dhe industrinë, të cilat plotësojnë gjithmonë testimet më të fundit të pavarura, standardet dhe rregulloret – duke i ofruar klientëve tanë qetësi të plotë mendore dhe duke i siguruar se po punojnë me një prodhues cilësor.

**TË MENDUARIT GLOBAL**
Sika ka një rrjet botëror prej 21 Qendrash Teknologjike të cilat drejtojnë programet afatgjata të kërkimit dhe zhvillimit të zgjidhjeve të reja inovatore. Për plotësimin e nevojave dhe kërkesave specifike të tregut vendor, janë zhvilluar gjithashtu produkte dhe sisteme të reja në këto 21 Qendrat Teknologjike. Ky proces na ndihmon për të lehtësuar optimizimin e kostos së prodhimit dhe çmimeve efikase në treg.

**400+**
PATENTA TË REJA U DEPOZITUAN QË NGA 2015

**500+**
SHPIKJE JANË REGJISTRUAR QË NGA 2015

**INOVACIONE QË KANË FITUAR ÇMIME**
Sika fitoi njohje globale për lidershipin e saj në inovacion duke fituar çmimin e lakmuar Swiss Technology për teknologjinë e saj të re me performancë të lartë të ngjitësave SikaForce® Powerflex. Kjo teknologji e re, përdoret në konstruksionet me peshë të lehtë në fushën e transportit, kombinon karakteristikat ngjitësave strukturorë elastikë dhe me rezistencë të lartë në një produkt të vetëm.



**PLOTËSIMI I PRITSHMËRIVE TË LARTA**
Të gjitha zgjidhjet nga Sika janë krijuar duke patur në mendje suksesin e klientëve tanë dhe ne kërkojmë të ndërtojmë marrëdhënie afatgjata e me përfitim reciprok sesa të përqëndrohemi në biznesin afatshkurtër. Synimi ynë është të fitojmë të gjitha sfidat me të cilat përballen klientët tanë duke hedhur në treg produkte të reja në përgjigjje të rregulloreve më të rrepta për ngjitësit dhe izoluesit, zhvillimi i zgjidhjeve të reja për të plotësuar edhe kërkesat më të larta në kushtet e aplikimit pa telashe dhe kompatibilitetit mjedisor në tregun e shtrimit të dyshemeve dhe plotësimit të kërkesave për konstruksionet me peshë të lehtë në industrinë e automobilave.





**NDËRTIMI I PËRSHPEJTUAR I TREGJEVE TË ZHVILLUARA**
Ne kemi rritur investimet tona në tregjet e reja, duke përshpejtuar ndërtimin e zinxhirëve vendorë të furnizimit. Gjatë viteve të fundit, ne hapëm më shumë se 50 fabrika të reja në tregjet e zhvilluara, duke na mundësuar të përforcojmë praninë tonë vendore dhe t'u shërbejmë më mirë kërkesave vendore. Kjo gjë përmirëson vazhdimisht afërsinë me klientët tanë gjë e cila na dallon në treg. Ne kemi një traditë të gjatë në hyrjen tek tregjet e reja në fazë fillestare; për shembull filialet e para në Amerikën Latine u themeluan gjatë viteve 1930. Kjo gjë na mundëson të marrim pjesë në zhvillimin e tregut dhe të ndërtojmë një pozicion të qëndrueshëm. Vizioni ynë është afatgjatë, duke i dhënë vlerë të madhe ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata me klientët.

MË SHUMË SE
**300**
FABRIKA NË BOTË

TREGJE TË REJA

# RRITJE NË MBARË BOTËN



Ne ndjekim një strategji rritjeje të përqëndruar në shitjet e kombinuara dhe ofrimin e zgjidhjeve për ndërtesat e reja dhe punimet restauruese. Markat tona të fuqishme mbështesin iniciativat e tregut globalisht. Ne sigurojmë se ofrojmë zgjidhje dhe jemi pranë klientit duke ndërtuar ekspertizën teknike brenda organizatave tona vendore, trajnimin e punonjësve vendorë dhe transferimin e njohurive teknike në bazë globale.

Duke u përqëndruar tek tregjet e reja, menaxhimin e projekteve kryesore, shitjet e kombinuara dhe depërtimin në treg ne drejtojmë të ardhmen e rritjes së Sika-s.

**TEKNOLOGJIA GLOBALE TAKON EKSPERTIZËN VENDORE**
Në të gjithë botën, biznesi ynë i ndërtimit është vendor. Ne ndërtojmë ekspertizën teknike brenda organizatave tona vendore, trajnojmë punonjësit vendas dhe transferojmë njohuritë teknike në bazë globale. Kjo gjë do të thotë se ne mund të garantojmë mbështetje vendore tek të gjithë kantieret, duke u bazuar në përvojën globale më shumë se 100 vjeçare.





**100**
SHTETE NË TË GJITHË KONTINENTET:
PRANI NË TË GJITHË BOTËN.

**BLERJET E KOMPANIVE**
Synimi ynë është të nxisim rritjen organike, që do të thotë rritje të nxitur nga inovacioni dhe fryma sipërmarrëse. Kjo rritje organike plotësohet me blerje të targetuara me kujdes të kompanive të cilat përforcojnë aksesin tonë në treg dhe përmirësojnë thelbin e biznesit tonë me teknologjitë përkatëse. Ne ndjekim këtë politikë si një mënyrë për të përmirësuar vazhdimisht pozicionin tonë në treg dhe për të patur një rol aktiv në konsolidimin e tregjeve të fragmentuara. Ne përpiqemi gjithmonë të sigurojmë një integrim të qetë dhe kushtojmë rëndësi të veçantë në kulturën vendore të korporatës, duke u kujdesur në akomodimin e nevojave e ekipit tonë të ri.



**MË SHUMË VLERË, MË PAK NDIKIM**
Ne jemi të përkushtuar për të qënë pionierët që ofrojnë zgjidhje të qëndrueshme për të adresuar sfidat globale dhe për ta arritur këtë në mënyrë të sigurt me ndikim minimal mbi burimet. Krijimi dhe shtimi i vlerës ndërsa reduktohet ndikimet – ky është synimi.

Strategjia jonë integron plotësisht qëndrueshmërinë (sustainability) tek të gjitha proceset e biznesit tonë dhe ne përpiqemi të krijojmë vlerë për klientët dhe partnerët tanë në të gjithë zinxhirin e furnizimit dhe kohëzgjatjes së produkteve tona.
Kjo vlerë e krijuar tejkalon ndikimet që lidhen me prodhimin, distribucionin dhe përdorimin.



**STEPHAN ENGELHARDT,**
INXHINIER APLIKIMI, ROOFING

"Ne i konsiderojmë klientët tanë si pjesë e ekipit tonë për të arritur synimin e përbashkët – tarraca/çati rezistente dhe cilësore."





**NJERËZIT TEK SIKA**
Ne besojmë në aftësinë dhe frymën sipërmarrëse të punonjësve tanë. Ekipi ynë është aseti më i madh që kemi dhe falë njerëzve të përkushtuar që në punësojmë, jemi të aftë të ofrojmë nivele të larta për shërbim klienti dhe shërbimi teknik. Është ky nivel i lartë shërbimi, krahas produkteve tona inovatore që na bën ne Sika.

**25,000+**
PERSONA TË PUNËSUAR NGA SIKA NË TË GJITHË BOTËN.



VLERA DHE PARIME

# KULTURA E KORPORATËS

Ne kemi perspektivë afatgjatë në zhvillimin e biznesit tonë dhe veprojmë me respekt dhe përgjegjësi ndaj klientave, aksionerëve dhe punonjësve tanë.

Suksesi i së ardhmes në kompaninë tonë, nuk varet vetëm nga ndjekja e strategjisë së duhur, por bazohet gjithashtu në besimin dhe përkushtimin e të gjithë punonjësve tanë.

**BUILDING TRUST**
Besimi është themeli i partneriteteve dhe bashkëpunimeve tona. Për ne kjo gjë shfaqet në cilësinë e punës sonë dhe është rezultati i fuqisë sonë inovatore dhe këmbënguljes. Megjithatë, nuk është një gjendje statike, por një proces i vazhdueshëm që duhet të kultivohet në mënyrë aktive. Marka Sika ekziston sepse çdo ditë ne investojmë vazhdimisht tek ndërtimi i besimit.



# BUILDING TRUST QË NGA VITI 1910

ÇDO VIT SIKA FURNIZON MJAFTUESHËM MEMBRANA HIDROIZOLIMI TARRACE PËR TË MBULUAR
**TË GJITHË QYTETIN E MANHATANIT**

MË SHUMË SE
**30 %**
REDUKTIM I ZHURMËS SË BRENDSHME NË MJETET MOTORIKE FALË ZGJIDHJEVE AKUSTIKE NGA SIKA

DUKE PËRDORUR IZOLUESIT E SIKA-S PËR INSTALIMIN AFATGJATË E DRITAREVE, MË SHUMË SE
**1 MILIONË**
KASA DRITARESH JANË IZOLUAR ÇDO VIT DUKE NDIHMUAR NË KURSIMIN E MË SHUMË SE
**10,000**
CISTERNASH ME VAJGUR PËR NGROHJE GJATË GJITHË CIKLIT TË JETËS SË TYRE

SISTEMET E SIKA-S PËR DYSHEME NË DHOMAT ME HIGJIENË TË LARTË KANË
**1,000 HERË MË PAK ÇLIRIME**
SESA SISTEMET STANDARDE ME VOC TË ULËT

ME MË SHUMË SE
**100 ÇMIME**
NË 20 VJET, SIKA ËSHTË KOMPANIA QË KA FITUAR MË SHUMË ÇMIME NË TË GJITHË BOTËN PËR PROJEKTET E RIPARIMIT TË BETONIT

FALË SERISË SË REDUKTUESVE TË UJIT NGA SIKA, MBI
**6 MILIARDË LITRA UJË**
KURSEHEN ÇDO VIT GJATË PRODHIMIT TË BETONIT

NË MBI 80 SHTETE, MË SHUMË SE
**10,000 KONTRAKTORË HIDROIZOLIMI TARRACE DHE ÇATIE**
JANË TRAJNUAR DHE CERTIFIKUAR NGA SIKA

**50 %**
E MAKINAVE QË PRODHOHEN NË TË GJITHË BOTËN PËRDORIN PRODUKTE NGA SIKA

BUILDING TRUST




# RIFINITURË NDËRTIMI

Sika ofron zgjidhje gjithëpërfshirëse për shtrimin e pllakave, mbrojtjen dhe dekorimin e fasadave si dhe finiturën e mureve të brendshëm për ndërtesat rezidenciale dhe komerciale. Zgjidhjet përbëhen nga ngjitësit dhe bojakët e pllakave, sisteme për hidroizolim poshtë pllakave dhe reduktim të zhurmave, veshje për finiturë fasadash dhe sisteme për termoizolim të jashtëm.

Trendi global i urbanizimit dhe nevoja në rritje për përmirësimin e banesës, përforcojnë më tej tregun. Nëpërmjet pranisë së qëndrueshme në kanalet e distribucionit që evoluojnë me shpejtësi, shërbimit të kontraktorëve dhe portofolit gjithpërfshirës me teknologji plotësuese për pjesën mbështjellëse të ndërtesës nga bazamenti tek çatia, Sika adreson kërkesën në rritje për cilësi, rehati, estetikë dhe zgjidhje miqësore ndaj mjedisit.

**INOVACIONET**

Përmirësimi i termoizolimit të fasadave mund të kursejë energji nga 30-35% ose dhe më tepër. Sika zhvillon zgjidhje për izolimin termik dhe akustik për fasadat si **Sika Thermocoat®** (EIFS). Për rinovimin e ndërtesave të vjetra, Sika ka zhvilluar sisteme inovative për suvatimin e fasadave, si llaçi i ri me bazë kërpi Parnatur®. Parnatur® aplikohet me shumë lehtësi dhe ka bazë burime të rinovueshme për rehati optimale të ajrit në ambient të brendshëm.
Sika ka zhvilluar gjithashtu një sistem të ri për hidroizolimin dhe shtrimin e pllakave në banjo. Përbëhet nga ngjitësit dhe bojakët e pllakave **SikaCeram®**, sistemi aplikohet me shpejtësi & lehtësi dhe përputhet me standardin europian ETAG 022.

**MARKAT KRYESORE**
- SikaCeram®
- SikaWall®
- Sika ThermoCoat®
- SikaMur®
- Sikagard®
- Sikalastic ®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Ngjitës dhe bojak për pllakat
- Izolim akustik nën pllaka
- Hidroizolim nën pllaka
- Mbrojtje dhe dekorim fasadash
- Termoizolim fasadash
- Rinovim i fasadave të vjetra
- Nivelim dhe finiturë e mureve të brendshëm

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/buildingfinishing**




# BETONI

Sika zhvillon dhe tregton një gamë të plotë aditivësh për prodhim betoni, çimentoje dhe llaçi. Këto produkte përmirësojnë vetitë specifike të betonit të freskët dhe të ngurtësuar, si punueshmëria, papërshkueshmëria nga uji, qëndrueshmëria apo rezistenca fillestare dhe përfundimtare.

Kërkesa për aditivë për momentin është në rritje, sidomos për shkak të kërkesave për performancë të lartë të betonit dhe llaçit, veçanërisht në zonat urbane dhe për ndërtim infrastrukturash. Për më tepër, përdorimi në rritje i materialeve alternative siç janë rëra e prodhuar, binderat alternativë dhe materialet suplementare tek llaçi dhe betoni është duke rritur nevojën për aditivë.

**INOVACIONET**

Punueshmëria e zgjatur mbi disa orë është veçanërisht e rëndësishme për kantieret e ndërtimit urban me trafik të ngjeshur apo zonat me kohë të gjata transporti. **Sika ViscoFlow®** është një aditiv përmirësues i punueshmërisë, i cili zgjat ndjeshëm kohën e punueshmërisë së betonit të freskët duke siguruar të njëjtin zhvillim rezistencash. Sidomos për gjeometritë jostandarde, një zgjidhje me saktësi të lartë printimi 3D ka avantazhe më të mëdha krahasuar me zgjidhjet konvencionale. Sika ka zhvilluar një zgjidhje-çelës **Sika® 3D** që përbëhet nga materialet, furnizimin me materiale, teknologjinë e printimit dhe përzierjes. Kjo teknologji është zgjidhja e duhur për elementet arkitekturore dhe ato të projektimit.

**MARKAT KRYESORE**
- Sika® ViscoCrete®
- Sikament®
- Sika® Plastiment®
- SikaPlast®
- Sika® Plastocrete®
- Sika® Sigunit®
- SikaGrind®
- Sika ViscoFlow®
- SikaPaver®
- SikaRapid®
- SikaFiber®
- SikaControl®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Kompanitë e betonit të gatshëm
- Kontraktorë ndërtimi
- Prodhuesit e parafabrikateve
- Fabrika llaçi të thatë
- Industria e çimentos
- Prodhim panelesh gipsi
- Industria e minierave

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/concrete**




# HIDROIZOLIM

Çdo gjë filloi për Sika-n në vitin 1910 me hidroizolimin. Sika ka qenë e para në përdorimin e shumë teknologjive dhe aplikimeve të reja përgjatë viteve dhe sot ofron një gamë të gjerë produktesh dhe sistemesh për hidroizolim mbi dhe nëndhe, përfshirë membranat fleksibël, membranat e lëngshme, llaçet për hidroizolim dhe aditivët për llaçet, profile dhe shirita për fugat, graute për injektim dhe shtresa për veshje.

Segmentet kyçe të tregut përfshijnë bazamentet dhe podiumet, tunelet dhe të gjitha llojet e strukturave ujëmbajtëse (rezervuarë, depozita, etj). Përzgjedhja e sistemit bëhet nga pronarët të cilëve u intereson së tepërmi menaxhimi i kostos totale dhe qëndrueshmëria e sistemit hidroizolues. Aplikimi i produktit kryhet nga kontraktorët e specializuar të hidroizolimit të cilët kërkojnë fortësi dhe produkte që aplikohen me lehtësi.

**INOVACIONET**

Ngjitja e plotë e membranave termoplastike mbi beton ka qenë një sfidë e madhe e teknologjisë. Gjatë viteve të shkuara Sika ka zhvilluar një shtresë integrale funksionale e cila ngjit dhe izolon membranën termoplastike mbi strukturën e betonit. Si produkti i parë, membrana **SikaProof® A+** për hidroizolim nëntokë përdor këtë teknologji unike, duke ofruar një sistem të fortë që aplikohet me lehtësi nga kontraktorët specialistë të hidroizolimit. Kjo teknologji ka gjithashtu potencial edhe në aplikime të tjera hidroizolimi dhe në të ardhmen do të nxirren në treg edhe produkte shtesë.

**MARKAT KRYESORE**
- Sikaplan®
- SikaProof®
- SikaBit®
- Sika Igolflex®
- SikaTop®
- Sika Waterbar®
- SikaFuko®
- SikaSwell®
- Sikadur-Combiflex®
- Sika® Injection

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Bazamente
- Tunele
- Urat
- Rezervuarë uji dhe ujërash të ndotur
- Puse dhe rezervuarë
- Termocentrale

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/waterproofing**




# TARRACA & ÇATI

Produktet, sistemet dhe shërbimet tona të shumta janë krijuar për tu përshtatur saktësisht me nevojat unike të projekteve specifike. Me më shumë se 55 vite përvojë hidroizolimi tarracash & çatish në vende të ndryshme të botës, Sika ka demonstruar një performancë shumë të besueshme, të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Kërkesa në këtë segment drejtohet nga nevoja për zgjidhje miqësore ndaj mjedisit, me efikasitet energjetik, si çatitë e gjelbra (green roofs), çatitë e ftohta (cool roofs) dhe çatitë solare (solar roofs). Ndërsa projektet e restaurimit vazhdojnë të fitojnë rëndësi në tregjet e maturuara, tregjet e reja po lëvizin drejt zgjidhjeve të cilësisë më të lartë.

**INOVACIONET**

Gjatë 50 viteve të fundit, Sarnafil® është vendosur si markë themelore në industrinë e hidroizolimit të çative. Sfiduam veten tonë për të prodhuar membranat e gjeneratës së ardhshme për çatitë. **Sarnafil® AT** është një teknologji hibride inteligjente e gjeneratës së re me fleksibilitet të lartë, aplikim të lehtë dhe jetëgjatë.
Shpejtësia është shumë e rëndësishme gjatë riparimit të çative. **Sikalastic® 851R** ofron një teknologji të re membranash të lëngshme që formon një shtresë hidroizoluese me tharje të shpejtë dhe trashësi të njëtrajtshme, pavarsisht formës së nënshtresës. **Sikalastic® 641** bazohet në një forcues të patentuar i-Cure®, i zhvilluar posaçërisht për përdorim në zona me ndjeshmëri të lartë.
Sistemet e membranave bituminoze **SikaBit® PRO** instalohen pa zjarr në përputhje me udhëzimet Safe2torch.

**MARKAT KRYESORE**
- Sarnafil®
- Sikaplan®
- Sikalastic®
- SikaBit®
- SikaFill®
- Sarnacol®
- Sarnatherm®
- Sarnamatic®
- Sikatherm®
- SikaRoof®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Çati/ tarraca të ekspozuara
- Çati/ tarraca me balast
- Çati/ tarraca në përdorim
- Sisteme çatish/ tarracash të gjelbra
- Çati/ tarraca të pjerrëta
- Çati/ tarraca të ftohta me membrana ose veshje me reflektivitet të lartë
- Çati/ tarraca solare
- Projektim çatish/tarracash të posaçme

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/roofing**




# SHTRIM DYSHEMEJE

Sika ofron finitura për dysheme që aplikohen në formë të lëngët dhe zgjidhje për mbrojtje, përmirësim dhe përfundim të sipërfaqeve të dyshemeve. Seria jonë e plotë zgjidhjeve për dysheme pa bashkime plotëson kërkesat e larta të sistemeve të dyshemeve industriale dhe dekorative. Përdorim teknologji të ndryshme si epoksidi, hibrid epoksid-poliuretan, P.M.M.A. dhe poliuretan.

Çdo segment tregu të cilit i shërbejnë sistemet tona është subjekt i kërkesave të veta të veçanta për sa i përket vetive mekanike, rregullores së sigurisë (rezistenca ndaj rrëshqitjes, higjiena, reagimi në zjarr), performanca funksionale, rezistenca kimike dhe qëndrueshmëria. Tendencat në tregun e shtrimit të dyshemeve diktohen nga rëndësia në rritje e rregulloreve të sigurisë dhe mjedisit, si dhe gjithashtu kërkesat teknike të personalizuara. Numri i lartë i projekteve për modifikim dhe konvertim ndërtese ditët e sotme ka rritur rëndësinë e zgjidhjeve efikase, si produktet e dyshemeve me tharje të shpejtë për riparimin e sistemeve ekzistuese të dyshemeve.

**INOVACIONET**

**Sikafloor®-2640** është veshja epokside e gjeneratës së re me formulë rrëshireje të zhvilluar tek Sika dhe të patentuar. Duke ruajtur vetitë standarde të dyshemesë epokside, Sikafloor®-2640 arrin tharje të plotë në vetëm në 2-5 ditë më pak se sistemet epokside konvencionale. Ka shumë pak erë gjatë aplikimit dhe çlirime të ulëta që plotësojnë kërkesat e rrepta të AgBB, A+ dhe LEED V4. Gjithashtu, teknologjia e re e forcuesit përmirëson rezistencën e sipërfaqes së dyshemesë ndaj UV. Produkti është më pak i ndjeshëm ndaj kushteve kritike të aplikimit, si temperaturat e ulëta dhe lagështia e lartë duke ofruar rezistencë më të mirë ndaj zbardhjes.

**MARKAT KRYESORE**
- Sikafloor®
- Sikafloor® EpoCem®
- Sikafloor® PurCem®
- Sikafloor® MultiDur
- Sikafloor® MultiFlex
- Sikafloor® DecoDur
- Sika® Comfortfloor®
- Sikalastic®
- Sikagard®
- SikaScreed®
- Sika® Permacor®
- Sika® Unitherm®
- SikaCor®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Dysheme industriale
- Dysheme parkimi automjetesh
- Dysheme betoni
- Dysheme komerciale, institucionale dhe rezidenciale
- Dysheme dhomash të pastra (clean-room)
- Mbrojtje për shkarkimin elektrostatik
- Fuga dyshemesh
- Veshje të posaçme për mure dhe tavane
- Mbrojtje kundër zjarrit/ korrodimit
- Veshje depozitash uji dhe mjediset e trajtimit të ujit

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/flooring**




# IZOLIM & NGJITJE

Në cilën pjesë të konstruksionit tuaj ka më shumë mundësi të hyjë uji? Tek fugat! Sika ofron një gamë të gjerë izoluesish, shiritash, shkumash dhe ngjitësish elastikë për fasadën e ndërtesës, pjesën e brendshme dhe infrastrukturën. Aplikimet tipike janë izolimi i fugave të lëvizjes midis elementeve të fasadave për rezistencë ndaj ndikimeve të motit dhe izolimin e fugave të aeroporteve dhe rrugëve për mbrojtje të tokës nga rrjedhja e karburantit.

Kërkesa në rritje në këtë treg ushqehet nga ndërgjegjësimi i rritur i rëndësisë së izoluesve me performancë të lartë për qendrueshmërinë dhe efikasitetin energjetik të ndërtesave, numri gjithnjë në rritje i projekteve të mëdha dhe zëvendësimi i vazhdueshëm i sistemeve me mbërthim mekanik nga ngjitësit për shkak të performancës më të mirë.

**INOVACIONET**

Zgjidhjet për mbrojtje kundër zjarrit po fitojnë rëndësi në nivel global për shkak të urbanizimit, ndërgjegjësimit dhe rregulloreve të reja. Sika ka lançuar seri të re produktesh me izolues zjarrdurues. Në rast zjarri tek ndërtesa, tymi dhe nxehtësia përhapen nëpërmjet depërtimeve dhe fugave duke rrezikuar banorët dhe duke bllokuar daljen e emergjencës. Zgjidhjet zjarrduruese nga Sika izolojnë depërtimet dhe fugat dhe ndihmojnë në mbajtjen zjarrit dhe tymit, duke u dhënë kohë banorëve të dalin të sigurtë nga ndërtesa. Produktet dhe sistemet zjarrduruese Sika pajtohen me standardet më të rëndësishme (EN, ETAG, UL, ASTM) që të sigurohet rezistenca më e lartë kundër zjarrit.

**MARKAT KRYESORE**
- Sikaflex®
- SikaBond®
- Sikasil®
- Sikacryl®
- SikaSeal®
- Sika Boom®
- Sika® MultiSeal

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Zgjidhje për veshjen e jashtme të ndërtesës
- Inxhinieri civile & fuga dyshemesh
- Zgjidhje për veshjen e dyshemeve
- Finiturë e mjediseve të brendshme
- Zgjidhje për ngjitjen
- Sisteme zjarrduruese

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/sealing-and-bonding**




# RESTAURIME

Sika ka zhvilluar procedura thelbësore dhe ka qenë pionere në krijimin e produkteve për restaurimin, riparimin dhe mbrojtjen e betonit të dëmtuar. Sika ishte prodhuesi i parë që zhvilloi dhe prezantoi teknologjinë e fibrave të karbonit për përforcimin e strukturave të betonit. Sika ofron teknologji për të gjithë ciklin e jetës së ndërtesave tregtare, rezidenciale dhe projektet e rehabilitimit infrastrukturor.

Veçanërisht në tregjet e zhvilluara, shumë struktura kanë vjetërsi prej disa dekadash dhe duhet të rinovohen. Tendenca aktuale e rritjes së kërkesës i atribuoet shtimit në numër të projekteve për rehabilitimin e infrastrukturës në transport, menaxhimin e ujit dhe sektorin e energjisë. Trendi i urbanizimit global dhe nevoja në rritje për rinovim ndërtesash në tregjet e zhvilluara po përforcojnë kërkesën.

**INOVACIONET**

Seria **SikaGrout®-3000** është portofoli i ri i grauteve me bazë çimentoje të zhvilluara posaçërisht për industrine on- dhe offshore të energjisë së erës. Këto llaçe me performancë të lartë janë një pjesë e rëndësishme e projektimit strukturor të kullës së erës, pasi mund të përdoren për të mbushur hapësirat dhe të transferojnë ngarkesat dhe forcat ekstreme. Seria e re e Sika's për llaçet shumëfunksionale u lejon klientave tanë të përfitojnë nga teknologjitë më të fundit të llaçeve. **Sika MonoTop®-4200 Multi Flow**, një llaç unik për riparimin strukturor të betonit, mund të adaptohet me lehtësi në konsistencën e kërkuar vetëm duke ndryshuar raportin e ujit.

**MARKAT KRYESORE**
- SikaGrout®
- Sika® FastFix
- Sikadur®
- Sika AnchorFix®
- Sika® CarboDur®
- SikaWrap®
- SikaLatex®
- Sika Top®
- Sika MonoTop®
- Sikagard®
- Sika® FerroGard®
- Sikacrete®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- Mbushje me graut
- Riparim betoni
- Mbrojtje betoni
- Impregnim hidrofob
- Ngjitje strukturore
- Përforcim strukturor
- Ankorim

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/refurbishment**




# INDUSTRIA

Tregjet që shërbehen nga Sika përfshijnë montimin e automobilave dhe automjetet (ngjitje strukturore, vendosje xhamash, sistemet akustike dhe përforcuese), zëvendësimi i xhamave, riparimi i skeletit të makinës, anijet detare, laminimi industrial, pajisjet, energjia e rinovueshme (dielli dhe era), fasadat inxhinierike (ngjitje strukturore e xhamave, izolimi i xhamave hermetizues) dhe ngjitje modulare.

Sika është lider në teknologji për ngjitjen elastike, ngjitësat strukturorë, izoluesit, përforcimin dhe aplikimet akustike që i shërben prodhuesve më të mëdhenj në botë. Klientët besojnë tek zgjidhjet e Sika-s për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së produktit, duke optimizuar efikasitetin e prodhimit. Për shembull, zgjidhjet e Sika-s adresojnë megatrende kyçe në projektimin e automjeteve, që çojnë në automjete më të lehta, më të forta, më të sigurta, më të qeta dhe më efikase, ndërkohë që materialet e procesimit të shpejtë dhe kompatibiliteti me automatizimin optimizojnë produktivitetin.

**INOVACIONET**

Sika fitoi Çmimin Swiss Technology 2019 në kategorinë "Innovation Leaders" për teknologjinë e re të ngjitësave me performancë të lartë që përdoren në konstruksionin me peshë të lehtë në sektorin e transportit: **SikaForce® Powerflex.** Kjo teknologji e re ngjitësi kombinon karakteristikat e ngjitësave strukturorë elastikë dhe me rezistencë të lartë në një produkt të vetëm. Në elektro-lëvizshmërinë dhe ndërtimin e shashisë me peshë të lehtë, fillerat dhe ngjitësit inovatorë përmirësojnë përçueshmërinë termike dhe vetitë e ngurtësisë së baterive të makinave dhe materialet përçuese të nxehtësisë së Sika-s kontribuojnë në reduktimin dramatik të kohës së ngarkimit me energji të baterisë.

**MARKAT KRYESORE NË INDUSTRI**
- Sikaflex®
- SikaBaffle®
- SikaTack®
- SikaPower®
- SikaForce®
- SikaReinforcer®
- SikaDamp®
- SikaMelt®
- SikaSeal®
- Sikasil®
- SikaBlock®
- SikaBiresin®
- SikaFast®

**FUSHAT KRYESORE TË APLIKIMIT**
- OEM dhe OES automobilistike
- Pjesë këmbimi automjetesh
- Industria e automjeteve komerciale
- Prodhim fasade dhe fenestrimi
- Ngjitje modulare
- Pajisjet dhe përbërësit industrialë
- Laminim industrial
- Industria e energjisë së rinovueshme
- Vegla përpunimi dhe përbërës
- Industria marine

Informacion i detajuar dhe referenca:
**www.sika.com/industry**

# WE
# ARE
# SIKA

TREGJET ←

→ KOMPANIA

BUILDING TRUST